REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.4140/16

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi - kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Mehmet Ndrecaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësve: H.H., S.K. dhe i mituri E.H., të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor - babai H.H., të gjithë nga Prishtina, të cilët i përfaqëson A.I., avokat në Prishtinë, sipas autorizimit, kundër të paditurës: Kompania e Sigurimeve "S...", me seli në Prishtinë, rr. "..." pn., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar K.P., sipas autorizimit, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të paditurës të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1670/12 i datës 14.07.2016, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 02.03.2020, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

I. REFUZOHET e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës: Kompania e Sigurimeve "S...", me seli në Prishtinë, rr. "..." pn., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1670/12 i datës 14.07.2016, në pikën I, të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial për paditësit: H.H., S.K. dhe E.H., VERTETOHET.

II. PRANOHET pjesërisht ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës: Kompania e Sigurimeve "S...", me seli në Prishtinë, rr. "..." pn., NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1670/12, i datës 14.07.2016, në pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me kamatën e gjykuar ashtu që: DETYROHET e paditura që paditësve t'ia paguajë kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë, sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar, për një vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 14.07.2016, e deri në pagesën definitive.

III. Mbetet i pashqyrtuar dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pikën II, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë dhe në pikën III, të dispozitivit për shpenzimet e procedurës.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.1670/12 i datës 14.07.2016, në pikën I, të dispozitivit, ka vendosur që: Pjesërisht miratohet kërkesëpadia e paditësve H.H., S.K. dhe E.H., të gjithë nga Prishtina, ashtu që Detyrohet e paditura KS. "S...",

me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial paditësve të lartpërmendur t'ia kompensoj shumën prej 2.354 €, paditësit H.H., shumën prej 2.927 €, paditëses S.K. dhe shumën prej 1.778 €, paditësit E.H., me kamatën përkatëse ligjore të cilën e paguajnë Bankat komerciale në Kosovë për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, nga dita e nxjerrjes së ekspertizës, datë 16.06.2016 e tutje, deri në pagesën definitive e krejt këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit dhe atë: Për paditësin H.H., për këto kritere të dëmit: për dhimbjet e përjetuara fizike, shumën prej 1.300 €, për friken e përjetuar shumën prej 900 €, për ndihmën e personit të tretë, shumën prej 50 €, për ushqim të përforcuar shumën prej 50 €, për shpenzimet materiale gjatë kohës së shërimit, shumën prej 54 €. Për paditësen S.K., për këto kritere të dëmit: për dhimbjet e përjetuara fizike, shumën prej 1.500 €, për friken e përjetuar, shumën prej 1.300 €, për ndihmën e personit të tretë, shumën prej 50 €, për ushqim të përforcuar shumën prej 50 €, për shpenzimet materiale gjatë kohës së shërimit, shumën prej 27 €. Për paditësin E.H., për këto kritere të dëmit: për dhimbjet e përjetuara fizike, shumën prej 1.100 €, për friken e përjetuar shumën prej 600 €, për ndihmën e personit të tretë, shumën prej 20 €, për ushqim të përforcuar shumën prej 50 €, për shpenzimet materiale gjatë kohës së shërimit, shumën prej 8 €. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që të: Refuzohet si e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë përtej shumave nga pika I, e dispozitivit të këtij aktgjykimi për paditësin H.H. nga shuma e përgjithshme e kërkuar prej 3.654 €, në emër të dëmit jomaterial iu refuzua shuma prej 1.300 €, për dhimbjet e përjetuara fizike u refuzua shuma prej 700 €, për friken e përjetuar u refuzua shuma prej 600 €. Sa i përket paditëses S.K., refuzohet kërkesëpadia përtej shumës së aprovuar, nga shuma e përgjithshme e kërkuar prej 4.127 €, në emër të dëmit jomaterial shuma prej 1.200 €, për dhimbjet e përjetuara fizike shumën prej 500 € dhe për friken e përjetuar shumën prej 700 €. Ndërsa sa i përket paditësit E.H., refuzohet kërkesëpadia nga shuma e përgjithshme prej 2.578 €, në emër të dëmit jomaterial shuma prej 800 €, për dhimbjet e përjetuara fizike, shumën prej 400 € dhe për friken e përjetuar, shumën prej 400 €. Në pikën III, të dispozitivit ka vendosur që të: Detyrohet e paditura KS. "S...", me seli në Prishtinë, që paditësve H.H., S.K. dhe E.K. nga Prishtina, në emër të shpenzimeve procedurale, në mënyrë solidare të ia kompensoj shumën prej 1.123 €, në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i të padituërës në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e atakuar të shkallës së parë ta prish dhe çështjen ta kthej në rigjykim për vendosje meritore.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të padituërës është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, me datë 22.06.2012, përmes të autorizuarit të tyre, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi, të precizuar si në

parashtresën e datës 29.06.2016, me të cilën kanë kërkuar që duke u mbështetur në praktiken gjyqësore dhe ekspertizën mjekësore t'iu paguaj paditëses sikurse vijon: I. Paditësit H.H.; a. Për dëmin jomaterial: 1. Për dhimbje fizike shumën prej 2.000 €, 2. Për frikë shumën prej 1.500 €, 3. b). Për dëmin material: 3. Për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj 50 €, për ushqim të përforcuar shumën prej 50 €, për shpenzimet materiale gjatë kohës së shërimit shumën prej 54 €, gjithsej shumën prej 3.654 €, II. Paditëses S.K.; a). Për dëmin jomaterial: 1. Për dhimbjet fizike shumën prej 2.000 €, për frikë shumën prej 2.000 €, b). Për dëmin material: 3. Për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj 50 €, për ushqim të përforcuar shumën prej 50 €, për shpenzimet materiale gjatë kohës së shërimit shumën prej 27 €, gjithsej shumën prej 4.127 €, III. Paditësit të mitur E.H.; a). Për dëmin jomaterial: 1. Për dhimbje fizike shumën prej 1.500 €, 2. Për frikë shumën prej 1.000 €, 3. b). Për dëmin material: 3. Për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj 20 €, për ushqim të përforcuar shumën prej 50 €, për shpenzimet materiale gjatë kohës së shërimit shumën prej 8 €, gjithsej shumën prej 2.578 €, gjithsej (1-3) 10.359 €. Të gjitha me kamatë siç i paguan banka për mjetet pa destinacion të caktuar, të afatizuara mbi 12 muaj duke filluar nga data e gjykimit gjer në pagesën përfundimtare. Ti paguaj edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumën prej 1.428 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1670/12, i datës 14.07.2016, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: nga raporti i aksidentit dhe raporti hetues, nr. 2012-AR-0833, i datës 16.06.2012, ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se me datën 16.06.2012, rreth orës 09:55, "Vëllezërit Fazliu", në Prishtinë, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, kur automjeti i markës "Mercedes", me targa ..., të cilin e drejtonte S.B., pa u bindur se mund të bënte kthim të sigurt në të majtë, bënë kthim gjysmërrethi ku ia prenë rrugën automjeti (markës "Volswagen Polo". me targa ..., i cili po vinte nga drejtimi i kundërt, e të cilin e ngiste H.H., e i cili me pjesën e përparme goditet nga automjeti B, ku lëndime trupore kanë pësuar paditësit. Nga raporti i aksidentit 2012-AR-0833 i datës 16.06.2012, ku është bërë përshkrimi i të dhënave për automjetet vërtetohet se automjetet si rezultat i lëshimeve të të cilave ka ndodhur aksidenti, automjeti i markës "Mercedes" me targa ..., ka qenë i siguruar te e paditura KS "S...", polica e sigurimit nr. 0003950727, me afat të vlefshmërisë deri me 11.07.2012. Nga raportet mjekësore të QKUK-së, të datës 16.06.2012, raporti nr. 18226, 18257 dhe raporti nr. 18238, si dhe raportet e datës 17.06.2012, raporti nr. 18380 dhe 18388, ka vërtetuar faktin se paditësit H.H., S.K. dhe E.H., si pasojë e lëndimeve të marra në aksidentin e komunikacionit kanë kërkuar ndihmë mjekësore në QKUK.

Për lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket dëmit material dhe jomaterial, gjykata e shkallës së parë, në cilësinë e provës ka marr për bazë mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. A.T. ortoped - traumatolog dhe Dr. V.B.R. psikiatër, të cilët në mendimin e tyre profesional të dhënë në ekspertizën mjekësore të datës 16.06.2016 kanë konstatuar se:

Paditësi: H.H. ka pësuar këto lëndime trupore: ndrydhje të regjionit të parakrahut të majtë, ndrydhje - përdredhje të regjionit të qafës, të cilat lëndime kualifikohen si lëndime të lehta trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve të pësuara, paditësi ka përjetuar

dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 2 ditë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm 15 ditë, të intensitetit të ulët në kohëzgjatje prej 3 muaj. Si pasojë e këtij aksidenti, paditësi ka përjetuar frikë dhe atë: frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 4 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 1 muaj, frikë sekondare me intensitet të ulët që ka zgjatur në periudhën prej 6 muaj. Shëmtim trupor nuk ka pasur. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka pasur. Ndihma e personit të tretë ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 10 ditësh. Ushqimi i përforcuar në kohëzgjatje prej 10 ditë. Shërimi klimaterik dhe fizioterapeutik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 7 ditësh.

Paditësja: S.K. ka pësuar këto lëndime trupore: ndrydhje të regjionit të qafës dhe kafazit të kraharorit, të cilat lëndime kualifikohen si lëndime të lehta trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve të pësuara, paditësja ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 2 ditë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm 15 ditë, të intensitetit të ulët në kohëzgjatje prej 3 muaj. Si pasojë e këtij aksidenti, paditësja ka përjetuar frikë dhe atë: frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 12 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 2 muaj, frikë sekondare me intensitet të ulët që ka zgjatur në periudhën prej 1 viti. Shëmtim trupor nuk ka pasur. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka pasur. Ndihma e personit të tretë ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 10 ditësh. Ushqimi i përforcuar në kohëzgjatje prej 10 ditë. Shërimi klimaterik dhe fizioterapeutik nuk ka qenë i nevojshëm.

Paditësit: E.H. ka pësuar këto lëndime trupore: ndrydhje të kokës dhe kafazit të kraharorit, të cilat lëndime kualifikohen si lëndime të lehta trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve të pësuara, paditësi ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 24 orë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm 10 ditë, të intensitetit të ulët në kohëzgjatje prej 2 muaj. Si pasojë e këtij aksidenti, paditësi ka përjetuar frikë dhe atë: frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 2 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 2 javë, frikë sekondare me intensitet të ulët që ka zgjatur në periudhën prej 2 muaj. Shëmtim trupor nuk ka pasur. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka pasur. Ndihma e personit të tretë ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 3 ditësh. Ushqimi i përforcuar në kohëzgjatje prej 10 ditë. Shërimi klimaterik dhe fizioterapeutik nuk ka qenë i nevojshëm.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar dispozitave nga nenet 154, 178 dhe 200 të LMD-së. Për kamatën gjykata ju ka referuar nenit 277 të LMD-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenet 449 dhe 452 paragraf 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të padituris se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e

pjesshme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika o) e LPK-së, për arsye se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes me aktgjykimin e atakuar, nuk ka tejkaluar kërkesëpadinë e paditësve, por e njëjta ka vendosur brenda kufijve të kërkesëpadisë së paditësve, të precizuar si në parashtresën e datës 29.06.2016, siç përcaktohet me nenin 2 paragraf 1 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara, gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se aksidenti i komunikacionit rrugor ka ndodhur me datë 16.06.2012, rreth orës 09:55 minuta, në rrugën "Vëllezërit Fazliu", në Prishtinë. Automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti ka qenë i siguruar te këtu e paditura, shkaktari kryesor i cili ka përgjegjësi ekskluzive dhe të vetme në shkaktimin e këtij aksidenti, është drejtuesi i automjetit i tipit "Mercedes 124", me targa ..., ngjyrë e kafet, të cilin në momentin e aksidentit e drejtonte S.B. nga Prishtina, i siguruari i këtu të paditurës, këtu paditësit nuk kanë përgjegjësi në shkaktimin e këtij aksidenti dhe si pasojë e këtij aksidenti, paditësit pësojnë lëndime të lehta trupore. Të gjitha këto rrethana nuk janë kontestuar nga palët - këtu e paditura, gjatë shqyrtimit kryesor në shkallë të parë, nuk e ka kundërshtuar bazën juridike sa i përket shkaktarit të aksidentit - përgjegjësinë e siguruarit të saj, siç është deklaruar përfaqësuesi i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 08.06.2016, nuk e ka kundërshtuar faktin se paditësit kanë pësuar lëndime të lehta trupore, nuk ka kontestuar se paditësit kanë përjetuar dhembje fizike dhe frikë, si pasojë e këtij aksidenti, siç kanë deklaruar ekspertët mjekësor në mendimin e tyre profesional dhe në këtë kuptim gjykata e shkallës të parë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike për faktin se me nenin 321 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së, përcaktohet se: " Nuk ka nevojë të provojë faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e më hershme, gjykata nuk ka nevojë të provoj as faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor ", në këtë rast e paditura i ka pohuar pothuajse të gjitha faktet e theksuara më lartë dhe më qëllim që kjo çështje të zgjidhet me marrëveshje, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 08.06.2016 ju ka ofruar ofertë në lartësi prej 1.000 € për secilin veç e veç, të cilën ofertë paditësit nuk e kanë pranuar.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësve, gjënë mbështetje në nenin 154, 158 dhe 178 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 30 Mars 1978, i cili ka hyrë në fuqi me datë 01 Tetor 1978.

Me nenin 154 të LMD-së, përcaktohet se: " Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoj, në çoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij ", me nenin 158 përcaktohet se: " Fajësia eksiton kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia ", ndërsa me nenin 178 përcaktohet se: " Në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesi të automjetit vihet në zbatim rregulla mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë ".

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me kërkesëpadinë sa i përket dëmit jomaterial për paditësit H.H., S.K. dhe E.H. dhe atë: për dhimbjet fizike dhe frikën e përjetuar, Gjykata e Apelit vlerësoj se gjykata e shkallë së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë për këto kategori të dëmit në atë mënyrë që shuma e gjykuar është në ekuivalencë më të mirën e shkelur/cenuar, duke siguruar që kompensimit të shërbej si satisfakcion për paditësit. Gjykata drejtë ka vlerësuar dhe vendosur sa i përket këtyre kategorive të dëmit jomaterial sepse vlerësimi i gjykatës është në harmoni edhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor, të cilët kanë konstatuar se paditësit kanë përjetuar dhimbje fizike dhe frikë të konstatuara si më lartë, e rrjedhimisht edhe me rrethanat tjera të cilat i ka marrë në konsideratë gjykata e të cilat ndikojnë në përcaktimin e lartësisë siç është në këtë rast natyra dhe pasojat e lëndimeve që kanë pësuar paditësit, llojin, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika si dhe rrethanat tjera si moshën e paditësve dhe praktiken e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plot me nenin 200 të LMD-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, më rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve H.H., S.K. dhe E.H., është e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material dhe atë: për ushqim të përforcuar dhe ndihmën e personit të tretë, për arsye se me nenin 195 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: " Kush i shkakton tjetrit lezionim trupor ose ja prish shëndetin ka për detyrë t'i kompensoje shpenzimet e mjekimit dhe shpenzimet e tjera te nevojshme lidhur më këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të pa aftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit ". Në këtë rast paditësve ju takon e drejta në kompensimin e dëmit material, për ndihmën e personit të huaj dhe ushqimin e përforcuar, përkundër faktit se paditësit për këto kategori të dëmit nuk kanë prezantuar prova konkrete materiale, kjo gjykatë vlerëson se duke u nisur nga praktika e gjertanishme e gjykatave në Kosovë, në bazë të së cilës është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve palët kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloji dëmi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete, gjykata ka konstatuar se në këtë rast paditësi H.H. ka pasur nevojë për ndihmë nga personi i huaj në kohëzgjatje prej 10 ditësh dhe ushqimi të përforcuar në kohëzgjatje prej 10 ditë, paditësja S.K. ka pasur nevojë për ndihmë nga personi i huaj në kohëzgjatje prej 10 ditë dhe ushqimi të përforcuar në kohëzgjatje prej 10 ditë dhe i mituri E.H. ka pasur nevojë për ndihmë nga personi i huaj në kohëzgjatje prej 3 ditë dhe ushqimi të përforcuar në kohëzgjatje prej 10 ditë, të njëjtëve ju takon ky lloji kompensimi i kërkuar në shumat e gjykuara, pasi që edhe më vetë kriteret e caktuara nga Kompanitë e Sigurimeve në Kosovë, të cilat nuk janë obliguese për gjykatat me rastin e vendosjes, por mund të merren si kritere orientuese, rezulton se të njëjtat në rastet e aksidenteve të komunikacioneve, të dëmtuarve ju njohin të drejtën në kompensimin e dëmit për ushqim të përforcuar dhe për kujdes nga personi i tretë. Ndërsa në këtë rast lartësia e kërkesës për këto kategori të dëmit është reale në raport me kohëzgjatjen për nevojën për ndihëm dhe kujdes nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me dëmin material për shpenzimet materiale gjatë kohës së shërimit, për paditësit: H.H., S.K. dhe E.H., Gjykata e Apelit vlerësoj se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme sepse baza juridike për këtë kategori të demit gjen mbështetje në nenin 195 paragraf 1 të LMD-së. Në këtë rast palës paditëse si pasojë e aksidentit ju kanë shkaktuar shpenzime të mjekimit dhe shpenzime tjera e lartësia e tyre është vërtetuar me prova dhe atë: dëftesë - pagesat dhe kuponët fiskal prezent në shkresat e lëndës, të cilat janë administruar si prova materiale nga gjykata e shkallës së parë.

Aktgjykimi është ndryshuar sa i përket kamatës sepse gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte aplikuar të drejtën materiale, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi e duke iu referuar nenit 277 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 14.07.2016, e deri në pagesën definitive, sepse pala paditëse për dëmin dhe lartësinë e tij, ka ra në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e tyre për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Pika II, e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë, dhe pika III, e dispozitivit për shpenzimet e procedurës, nuk janë shqyrtuar sepse ankesa nuk ka qenë e drejtuar përkitazi me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë dhe për shpenzimet e procedurës.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) dhe e), e lidhur me nenin 201 paragraf 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4140/16, me datë 02.03.2020

Kryetari i kolegjit
Rrustem Thaqi, d.v